

AKTI I THEMELIMIT

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË ZAHO sh.p.k

Sot më 15.03.2022 (dymijë e njëzet e dy), personat e poshtëshënuar:

- Blerina Zaho, i bija i Qemalit dhe Sanies, lindur në Tiranë më 02.03.1985 dhe banues në Tiranë, me Karte Identiteti me Nr. 032701593, me Numër Personal I55302072P;

VENDOSI :

NENI 1

Me vullnet të lirë dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar të krijojë shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar ZAHO sh.p.k, me titull dallues **ZAHO Sh.p.k.** dhe kapital themeltar 2'500'000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: Rruga "Muhamet Gjollesha", Pallati 67, Kati 1. Aktiviteti i saj do të zhvillohet në Tiranë dhe do të shtrihet në të gjithë territorin shtetëror të Republikës së Shqipërisë. Transferimi i Shoqërise në një adresë tjeter bëhet me miratimin e ortakut.

Ortak i kësaj shoqërie dhe pronarë të saj do të jenë:

1. Blerina Qemal Zaho

- Administratori i vetëm i kësaj shoqërie, do të jetë Blerina Zaho, i bija i Qemalit dhe Sanies, lindur në Tiranë më 02.03.1985 dhe banues në Tiranë, me Karte Identiteti me Nr. 032701593, me Numër Personal I55302072P, per nje afat të përcaktuar prej pesë vitesh.
- Shoqeria ZAHO sh.p.k, ka te drejte te krijoje filiale te saj brenda vendit, ne çdo kohë që të shihet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

NENI 2

Shoqëria ZAHO sh.p.k., me titull dallues **ZAHO sh.p.k.** gëzon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do të zhvillohet në bazë të këtij Akti Themelimi, Statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi. Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij Akti Themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si më poshtë vijon :

Këmbim valutor. Biletari. Veprimtari e agjentit për transfertë parash në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo bankë. Veprimtari e agjentit për shërbimin e pagesave për të tretët në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo bankë. Veprimtari e agjentit komisioner.

NENI 4

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat të pacaktur, duke filluar nga momenti i rregjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 500 000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë.

Ai është ndarë në 1 (një) kuotë të barabartë plotësisht të shlyera me vlerë nominale 2 500 000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë.

Fondet që rrjedhin nga shlyerja e pjesëve janë depozituar në Bankë, per llogari të Shoqërisë në krijim e sipër.

Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëloje kapitalin e saj.

Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakut .

NENI 6

Kapitali themeltar përbëhet nga kontributet e mëposhtme:

1. Zj. Blerina Zaho kontribuon në shumën 2 500 000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë

NENI 7

Në bazë të kontributeve të sipërpërmendura:

1. Z. Blerina Zaho ka 100% (njëqind përqind) pjesë të kapitalit themeltar.

Të gjitha pjesët që përbëjnë kapitalin themeltar janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ortakët.

NENI 8

Ortakët themelues të shoqërisë vendosin për prishjen e shoqërisë para mbarimit të afatit në rast se veprimtaria e saj është jo efektive ose për raste të tjera të përcaktuara në satatutin e shoqërisë dhe të parashikuar në Ligj.

NENI 9

Shpenzimet që do të kryhen deri në rregjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin ekonomik të shoqërisë.

Ky akt themelimi është hartuar në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje më vlerë të njëjtë ligjore, një kopje në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Kopjet e tjera do të depozitoohen në Arkivin e Shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

BLERINA ZAHO